



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:065692

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05746793

KPPP.nr.1543/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit "Natyra Dea" Sh.P.K., me NUI:810815821, me seli në Prishtinë, Rr."Dëshmorët e Gollakut" Hajvali, kundër debitorit "Florenti 3" N.P.T., me NUI:811305334, me seli në Mitrovicë, Rr."Shemsi Ahmeti", duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.241/22 të datës 27.05.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit "Florenti 3" N.P.T., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.241/22 i datës 27.05.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.241/22 i datës 27.05.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupi.
- III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 2,528.59 €.
- IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Natyra Dea” Sh.P.K., me NUI:810815821, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.241/22 të datës 27.05.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht fatura me numër 100520006 e datës 05.10.2020, fatura me numër 101320005 e datës 13.10.2020, fatura me numër 101320003 e datës 13.10.2020, fatura me numër 101920023 e datës 19.10.2020, fatura me numër 090720006 e datës 07.09.2020, fatura me numër 091420018 e datës 14.09.2020, fatura me numër 092820001 e datës 28.09.2020, fatura me numër 081720003 e datës 17.08.2020, fatura me numër 082520004 e datës 25.08.2020, fatura me numër 072220031 e datës 22.07.2020, fatura me numër 072820006 e datës 28.07.2020, fatura me numër 060220007 e datës 02.06.2020, fatura me numër 061520014 e datës 15.06.2020, fatura me numër 051520002 e datës 15.05.2020, fatura me numër 040720035 e datës 07.04.2020, fatura me numër 041320017 e datës 13.04.2020, fatura me numër 041320016 e datës 13.04.2020, fatura me numër 032320031 e datës 23.03.2020, fatura me numër 032320030 e datës 23.03.2020, fatura me numër 021120007 e datës 11.02.2020, fatura me numër 022420023 e datës 24.02.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të mbetur sipas faturave të lartcekura në shumë prej 2,528.59 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes për pagesë, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ndër të tjerash ka theksuar se kreditori dhe debitori kanë lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me të cilën janë pajtuar duke u mbështetur në rregullat e moralit afarist- dokeve të mira afariste që në çdo fund vit apo fillimin e vitit të ardhshëm kalendarik të bëjë proces barazimin në koordinim të përbashkët , për konfirmimin e saldove financiare, e në rrethana të tilla konsideron se në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave ligjore. Ka shtuar se në një rast të tillë kemi të bëjmë edhe me shkelje të dispozitave materiale të LPP-së. Kreditori nuk ka treguar gatishmërinë që në bashkëpunim me debitorin ti përmbahet marrëveshjes së tyre të bashkëpunimit dhe ti barazojnë obligimet e tyre financiare. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin si të bazuar, të prishet urdhri përmbartimor dhe të abrogohen të gjitha veprimet.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se debitori ka paraqitur prapësim me të vetmen arsye që me anë të keqpërdorimit të së drejtës të arrit të zvarris procedurën përmbarimore. Ka shtuar se pas shumë tentativave për marrjen e një përgjigje nga ana e debitorit për pagesën e obligimeve asnjëra nuk është realizuar dhe kjo na e ka bërë të pamundur që çështjen ta zgjidhim me marrëveshje me debitorin. Ka theksuar se si kompani nuk kanë asnjë arsye logjike që një klient ta procesojmë për përmbarim përveç rasteve kur klienti tregon mosbashkëpunim në tërësi. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, të lejohet urdhri përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht faturat e lartcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët,

përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në original nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se urdhri për përmbarim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1543/22, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.